



AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/317
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I53-2 Prot.
Nr. Dok. 202503003/2

Tiranë _17/_12/2025

Lënda: *Rekomandim mbi inspektimin e kryer në IEVP Fier*

Drejtuar: **Z. Klevis QOSE**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Arben QALLIU
Drejtor i IEVP-së Fier

FIER

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet pas inspektimit të paparalajmëruar që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fier.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat e dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fier.

Inspektimi u krye më datë 03.07.2025, sipas planit vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z. Hazbi Selita, znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Lindita Dedëgjoni, z. Vullnet Topalli dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve dhe kushtet infrastrukturore për jetesë normale, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ligjore kombëtare dhe standardet ndërkombëtare për këtë qëllim. Gjithashtu, inspektimi kishte si qëllim edhe verifikimin e progresit që strukturat përgjegjëse në IEVP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve,

kanë bërë për zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, dërguar përmes raportit me rekomandime më datë 31 Korrik 2024¹.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit ju ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të dënuarit dhe paraburgosurit në këtë institucion, ambientet e banimit, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, në ambientin e infermierisë, klasat e edukimit, kuzhinë, lavanderi etj., si dhe bënë këqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga punonjësit sipas sektorëve të institucionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë gjetjet e inspektimit si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Vizita inspektuese në IEVP Fier, u zhvillua në kuadër të inspektimeve periodike që zhvillon MKPT në institucionet ku privohet liria e personit, në mënyrë të paparalajmëruar në bazë të kompetencave të parashikuara në ligjin nr. 81/2020, *“Për të drejtat e dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtorin e institucionit z. Arben Qalliu dhe shefin e policisë z. Ardian Hysi, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Grupi i inspektimit kërkoj gjithashtu vënien në dispozicion të kopjeve të praktikave të punës që ndiqen nga sektori juridik, sektori psiko-social, sektori i shërbimit shëndetësor, kopje të organikës së institucionit, si dhe të informacioneve të dërguara Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga sektori ekonomik dhe ai i burimeve njerëzore, në lidhje me planifikimin e fondeve për investime në godinat e banimit në regjimin e brendshëm etj.

Drejtuesit e institucionit informuan për respektimin e të drejtave të të burgosurve, plotësimin e kushteve infrastrukturore në regjimin e brendshëm, si dhe për aktivitetet që zhvillohen me të burgosurit me qëllim rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, grupi i inspektimit u informua edhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm.

Bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 624, datë 16.12.2024, *“Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”*, IEVP Fier, klasifikohet për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion për personat që konsiderohen bashkëpunëtorë të drejtësisë, sipas kriterëve të ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009, *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*, i ndryshuar, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion paraburgimi.

IEVP Fier ka një kapacitet për akomodimin e 850 personave, referuar numrit të dhomave dhe të shtretërve në a) godinat e banimit; b) sektorin e veçimit dhe të observimit; c) sektorin e kujdesit të veçantë (SKV); d) sektorin e infermierisë dhe të spitalit; si dhe, e) sektorin e bashkëpunëtorëve të mbrojtur të drejtësisë.

Ndërsa, vetëm godinat e banimit kanë **kapacitet fizik për 828 persona** të dënuar dhe të paraburgosur, mbështetur në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.735, datë

¹ Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I33-2 prot., datë 31.07.2024.

04.05.2023, “Për miratimin e kapaciteteve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e regjimit të brendshëm **ndodheshin 680 të burgosur**, të ndarë sipas sektorëve:

- 394 persona në sektorin e të paraburgosurve;
- 262 persona dhe sektorin e të dënuarve;
- 4 persona në sektorin e bashkëpunëtorëve të mbrojtur të drejtësisë;
- 13 persona në sektorin e kujdesit të veçantë (SKV);
- 7 persona në observim.

Situata e popullimit në godinat e banimit për periudhën e fundit 7-mujore, ka qenë si më poshtë vijon:

- janar 2025 -780 të burgosur (384 të dënuar dhe 396 të p/b)
- shkurt 2025 - 766 të burgosur (393 të dënuar dhe 373 të p/b)
- mars 2025 - 762 të burgosur (385 të dënuar dhe 376 të p/b)
- prill 2025 - 733 të burgosur (354 të dënuar dhe 379 të p/b)
- maj 2025 - 674 të burgosur (337 të dënuar dhe 337 të p/b)
- qershor 2025 - 678 të burgosur (280 të dënuar dhe 398 të p/b)
- korrik 2025 - 680 të burgosur (287 të dënuar dhe 393 të p/b)

Ndonëse në institucion nuk ka mbipopullim në numrin e përgjithshëm të të burgosurve referuar kapaciteteve të institucionit, sektori i paraburgimit paraqitet me një numër të lartë prej 393 paraburgosur, ndërsa kapaciteti i këtij sektori është për mbajtjen dhe trajtimin e 324 personave, pra 69 paraburgosur më shumë se kapaciteti i numrit përcaktues.

Për shkak të numrit të lartë të të paraburgosurve, institucioni ka rritur numrin e shtretërve në dhomat e banimit në sektor, duke mos zbatuar standardet sipas kriterëve dhe kushteve përse i takon kubaturës dhe sipërfaqes së lejueshme për person në dhomat e banimit, të parashikuara në aktet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. Pavarësisht kësaj situatë, grupi inspektues konstatoi se në disa dhoma kishte të paraburgosur që flinin me dyshekë në dysheme, në kushtet e një trajtimi çnjerëzor dhe degradues.

Shkelja e këtij standardi, është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitës monitoruese në Shqipëri në vitin 2018. Në zbatim të rekomandimeve edhe të KPT-së (CPT) është bërë përmirësimi edhe i kuadrit ligjor, duke miratuar ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku është parashikuar pikërisht standardi ndërkombëtar për normën jetike të vendosjes së të paraburgosurve në ambientet e banimit, duke mbajtur parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe të të burgosurve, “....por në çdo rast duke iu siguruar **kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m²** për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar...”².

Ndërkohë, në datë 8.12.2022, edhe Komisioni Evropian ka publikuar rekomandimin “Mbi të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të akuzuarve që i nënshtrohen paraburgimit dhe për kushtet materiale të paraburgimit” ku ka rekomanduar që shtetet anëtare duhet t'i caktojnë çdo të paraburgosuri një sipërfaqe minimale prej të paktën 6 m² në qelitë me një

² Neni 33/4 i ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

person dhe 4 m² në qelitë me shumë persona. Shtetet anëtare duhet të garantojnë që hapësira personale minimale absolute në dispozicion për çdo të paraburgosur, përfshirë në një qeli me shumë persona, të vlerësohet me sipërfaqe ekuivalente me të paktën 3 m² për çdo të paraburgosur. Në rastet kur hapësira personale në dispozicion të një të paraburgosuri është nën 3 m², ngrihet një prezumim i fortë i shkeljes së nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut³.

Nisur nga gjetjet e inspektimeve, mbi situatën e popullimit, Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rishpërndarjen e drejtë dhe të balancuar të të burgosurve në institucionet e sistemit penitenciar, sipas kategorizimit të IEVP-ve, duke marrë në konsideratë parametrat teknike të ndërtimit të godinave të banimit. Rritja e numrit të shtretërve në dhomat ekzistuese të banimit, nuk e ul mbipopullimin në IEVP, por rrit në mënyrë fiktive numrin e të paraburgosurve brenda së njëjtës sipërfaqe banimi. Tërësia e masave që ndërmerren në sistemin e burgjeve, duhet të jetë në drejtim të përmirësimit të jetesës dhe jo përkeqësimit të kushteve të trajtimit dhe kushteve të jetesës së të paraburgosurve.

Infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit përbëhet nga 5 godina, të ndara në 3 (tre) godina (A, B dhe C) për akomodimin e personave të dënuar, 1 (një) godinë për të paraburgosurit dhe 1 (një) godinë e ambienteve ndihmëse.

- Godinat e banimit për të dënuarit (A, B dhe C) kanë në total 437 dhoma banimi, të ndara në 389 dhoma dyshe dhe 48 dhoma teke. Godinat janë tre katëshe dhe kanë 6 sektorë, ku 2 sektorë kanë 19 dhoma në secilin kat banimi (17 dhoma dyshe dhe 2 dhoma teke). Godinat kanë kapacitet 216 vende secila.
- Godina e p/burgimit ka 108 dhoma banimi, nga të cilat 85 dhoma banimi janë dyshe dhe 23 dhoma janë teke. Godina është tre katëshe, me 2 sektorë me 19 dhoma në secilin kat banimi (17 dhoma dyshe dhe 2 dhoma teke).
- Sektori për të dënuarit që kanë statusin e bashkëpunëtorit të mbrojtur të drejtësisë, ka 13 dhoma teke dhe ndodheshin 4 persona.
- Në secilin sektor ndodhen gjithashtu 6 dhoma (përveç dhomave të banimit) të cilat shërbejnë si ambiente ndihmëse për të burgosurit. Konkretisht: i) ambienti i dushit me 4-5 poste për larjen e trupit me ujë të ngrohtë; ii) palestra me veglat e forcës; iii) klasa për kalimin e kohës së lirë; iv) dhoma e edukimit për punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore ku zhvillohen me të burgosurit programet individuale të këshillimeve dhe aktivitete me grupe të burgosurish 3-5 persona; v) lavanderia për larjen dhe tharjen e rrobave të të burgosurve; si dhe vi) magazina për ruajtjen e materialeve të çdo sektori.
- Për secilën godinë banimi ka nga 4 bokse ajrimi, nga të cilat njëra është fushë (kalçeto) për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Infrastruktura në godinën e ambienteve ndihmëse, sipas sektorëve, paraqitet si më poshtë vijon:

- Spektori i Kujdesit të Veçantë (SKV) ka 18 dhoma teke. Dhomat janë të kompletuara me krevate dhe materiale fjetje për një person. Në kohën e inspektimit kishte 13 pacientë të shtruar, me probleme të shëndetit mendor.

³ [1_1_201158_rec_pro_det_en\[3927\].pdf](#)

- Sektori i infermierisë (spitali), ka 11 dhoma, nga të cilat 8 dhoma teke dhe 3 dhoma dyshe, me kapacitet për 14 persona. Në kohën e inspektimit ishin 4 të burgosur të shtruar sipas rekomandimit të mjekut të institucionit. Në sektorin e infermierisë ndodhen gjithashtu dhoma e mjekut, dhoma e infermierisë, dhoma e dentistit, farmacia, si dhe disa dhoma për mbajtjen e materialeve dhe pajisjeve mjekësore ndihmëse.
- Sektori i observimit, ka 16 dhoma me nga 2 shtretër. Në kohën e inspektimit kishte 7 të burgosur.
- Sektori i veçimit, ka 6 dhoma me nga 1 shtrat. Në momentin e inspektimit, në këtë ambient nuk ndodhej asnjë person me masë disiplinore “Mbikëqyrje e veçantë”.
- Në këtë godinë janë funksionale ambiente si: biblioteka me libra artistikë dhe biblioteka me libra fetarë, ambientet e kultit (xhamia, kisha ortodokse, kisha ungjillore), dhoma e psikologut, kursi i kuzhinës, kursi i anglishtes, klasa e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, arkiva e institucionit, etj.

Ambientet e banimit dhe ambientet ndihmëse, në përgjithësi ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Struktura organike e IEVP-së Fier, është e miratuar me Urdhër të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë nr. 43, datë 25.03.2021, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj”*. Organika e institucionit përbëhet nga 453 punonjës, nga të cilët 60 punonjës civilë dhe 393 punonjës të policisë së burgjeve. Nga informacioni, mungesat në organikën e institucionit, rezultonin si më poshtë vijon:

- Në stafin civil 5 vende vakante: 1 mjek psikiatër, 1 kuzhiner, 1 specialist për ushqimin dhe 2 punonjës socialë.
- Në stafin e policisë 31 vende vakante, kryesisht punonjës policie të rolit bazë.

Mungesat në organikë, përbëjnë problem shqetësues për garantimin e sigurisë, jetës dhe shëndetit të të burgosurve, ndaj është e domosdoshme të përshpejtohen procedurat për rekrutimin sa më parë të punonjësve civilë dhe policor, pasi IEVP Fier është një burg me infrastrukturë dhe kapacitet të madh, ndaj për menaxhimin e tij kërkohet që organika të jetë e plotësuar në përputhje me strukturën organike të miratuar. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, vendet vakante në stafin e policisë, sektorin e shëndetësisë, sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektorin e çështjeve shoqërore, do të plotësohen së shpejti, pasi propozimet për specialistët sipas fushave, ishin dërguar pranë DPB-së⁴.

Grupi i inspektimit, verifikoi zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm në IEVP-në Fier, ku rezultoi se ishin realizuar rekomandimet si më poshtë vijon:

1. Ishin marrë pjesërisht masat, për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit, kryesisht në stafin e policisë (47 vende vakante në vitin 2024, në 31

⁴ Aktualisht, nga informacioni i drejtorit të IEVP-së, janë në pritje të emërimit për të plotësuar vendi vakant i kuzhinerit dhe i specialistit në sektorin e burimeve njerëzore dhe të shërbimeve. Ndërsa në sektorin e policisë vazhdojnë procedurat e konkurimit për plotësimin e vendeve vakante.

vende vakante që janë aktualisht), për të garantuar sigurinë ndaj të burgosurve që vuajnë dënimin në këtë institucion.

2. Ishin marrë masat e nevojshme nga sektori i çështjeve shoqërore, për organizimin e aktiviteteve të larmishme me pjesëmarrjen e gjerë të të burgosurve.
3. Ishin marrë masat për organizimin e klasave profesionale për riaftësimin e të burgosurve.
4. Ishin marrë masat për të verifikuar zbatimin korrekt të kontratës së kompanisë së sjelljes së produkteve ushqimore në lidhje me çmimet dhe cilësinë e produkteve.
5. Ishin marrë masa nga DPB për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP-së Fier.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet e MKPT-së të cilat sipas informacionit, nuk ishin realizuar dhe konkretisht:

6. Nuk ishin marrë masat për shtimin e numrit të infermierëve në institucion kjo nisur nga numri i lartë i të burgosurve që ndodhen në institucion, si dhe duke u bazuar dhe në rekomandimet e CPT përgjatë vizitës së zhvilluar në IEVP Fier në maj 2023.
7. Nuk ishin marrë masat nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të siguruar që personeli i kujdesit shëndetësor në burgje të marrin trajnime të rregullta në aftësitë bazë të mbështetjes së jetës (përfshirë përdorimin e një defibrilatori).
8. Nuk ishin marrë masat e nevojshme, për eliminimin e lagështirës në godinën e të paraburgosurve dhe ambientet e dusheve në regjimin e brendshëm, pasi ndikon në përkeqësimin e shëndetit të të burgosurve.
9. Nuk ishin marrë masat për rikonstruksionin e ambienteve të dusheve në sektorin e paraburgimit dhe kompletimin me koka dushi të reja.
10. Nuk ishin marrë masat për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve me orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.
11. Nuk ishin marrë masat për përmirësimin e menusë javore në kuzhinën e institucionit, miratuar nga drejtori i institucionit, me qëllim larmishmërinë në gatimin e ushqimit për të burgosurit.

Pavarësisht disa mangësive të konstatuara nga grupi i inspektimit, Avokati i Popullit vlerëson se IEVP Fier plotëson kushtet infrastrukturore të nevojshme për jetesë normale të të burgosurve, zhvillimin e aktiviteteve social- kulturore e sportive, si dhe për ushtrimin e aktiviteteve me karakter fetar, sipas llojit të besimit.

Trajtimi i të dënuarve/paraburgosurve

Grupi i inspektimit kishte si qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve, për identifikimin e rasteve të përdorimit të dhunës fizike, të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të lejuar apo të presionit psikologjik ndaj tyre.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të burgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime të të burgosurve për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike, si dhe tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve ndaj tyre.

Lidhur me qëllimin e inspektimit, u verifikua gjithashtu praktika e punës së komisionit për dhënien e masave disiplinore për të burgosurit që kanë kryer shkelje disiplinore. Trajtimi i të burgosurve me masë disiplinore, kryhej në ambiente të përshtatshme të krijuara për këtë qëllim në këtë institucion, si dhe alternimin e masave disiplinore, në përputhje me personalitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata

kanë, duke synuar rehabilitimin për ri-integrimin në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike të tyre.

Pranimi i hyrjeve të reja në institucion dhe trajtimi i tyre, kryhej sipas kërkesave të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Komisioni i pritjes i ngritur me urdhër të drejtorit të IEVP-së, përbëhet nga përfaqësues të sektorit ligjor, përfaqësues të sektorit të çështjeve shoqërore, përfaqësues të shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë.

Të burgosurit që hynin rishtazi në institucion, u jepej informacioni i nevojshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe ishin njohur me rregulloren e institucionit, në formë verbale dhe të shkruar në gjuhën që ata e kuptojnë. Menjëherë pas pranimi në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen e gjendjes shëndetësore fizike dhe psikologjike, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e shenjave të dëmtimeve fizike, që janë shkaktuar jashtë institucionit në kohën e kontrollit.

Gjithashtu, u evidentua se, në sektorin e shëndetësisë ishte hapur edhe regjistri për regjistrimin e shenjave dhe dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimi, së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara⁵.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se rregullat e disiplinës në këtë institucion zbatoheshin në përshtatje me moshën, gjendjen fizike, psikike e psikologjike të të burgosurve, me qëllim stimulimin e ndjenjës së përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të tyre, dhe jo duke i konsideruar ato thjesht e vetëm si masa ndëshkuese⁶.

Gjithashtu nga grupi i inspektimit u verifikua plotësimi i kushteve materiale të jetesës për të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë institucion. Inspektimi u përqëndrua kryesisht tek kushtet e banimit, popullimi në dhoma, higjiena personale, kushtet sanitare, veshjet, cilësia e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Godinat në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, garantonin sigurinë dhe kushtet e qëndrimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, për kryerjen e veprimeve sipas orarit ditor, si dhe ofronin mundësi për të përballuar dinamikën e hyrjeve të reja dhe transferimit të të paraburgosurve në IEVP-të e tjera, situatë kjo që ndryshonte çdo ditë në varësi të vendimeve të gjykatave.

Por në intervistat me të burgosurit, grupit të inspektimit ju paraqitën disa ankesa në lidhje me situatën e mbipopullimit në dhomat e banimit. Numri shtesë i personave, pajisja me krevatë dhe materiale personale për fjetje në dhomat e banimit, përveçse kishte ngushtuar hapësirat e sipërfaqeve të dhomave, duke mos respektuar standardin minimal kombëtar prej 4 m² hapësirë akomodimi për të burgosur në qelitë me shumë persona.

⁵ Neni 38/10 i ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* parashikon se: *“Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimi, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara. Nëse ka të dhëna dhe fakte që krijojnë bindjen e arsyeshme se ndaj tij mund të jetë kryer veprë penale, njoftohen organet e procedimit penal në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale”*.

⁶ Nenet 60-67 të ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Gjithashtu, gjatë inspektimit në dhomat e banimit u konstatuan 4 raste që në mungesë të krevatëve, të burgosurit flinin me dyshekë në tokë. Ky shqetësim është adresuar në mënyrë të përsëritur nga institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet rekomandimeve dërguar strukturave përgjegjëse në DPB dhe në IEVP. Bazuar në standardet ndërkombëtare dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁷, është në përgjegjësinë e DPB-së dhe IEVP-ve të marrin masa për shpërndarjen në mënyrë proporcionale të të burgosurve brenda kapaciteteve që kanë këto institucione, me qëllim përballimin e situatës së mbipopullimit në burgje, si dhe pajisjen me krevatë të të burgosurve, pasi fjetja në tokë përbën trajtim degradues për këta persona.

Në intervistat me të burgosurit, u evidentuan ankesa që kishin të bënin me lagështirën kryesisht në katet e para të godinave të banimit dhe ambientet e dusheve. Pavarësisht disa mermetimeve të kryera në këto ambiente me fondet e institucionit, në disa ambiente ende kishte lagështirë. Një nga faktorët e lagështirës, ka të bëjë me faktin se godinat e institucionit janë të ndërtuara në një zonë moçalishte dhe me ujë në të gjithë perimetrin e rrethimit të jashtëm. Situata e lagështirës përsëritet sidomos në periudha kur ka rreshje të mëdha të shirave.

Grupi i inspektimit, mori ankesa nga të burgosurit edhe për mosfunksionimin e sistemit të kalidajës, që shërben për ngrohje/ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm. Ky shqetësim bëhej serioz gjatë stinës së dimrit kur temperaturat në këtë zonë ishin të ulta deri nën zero. Institucioni për periudhën e dimrit kishte lejuar futjen në regjimin e brendshëm të ngrohëseve elektrike, ndërsa në verë të pajisjeve elektrike për ftohje, të cilat veç funksionit të tyre, kishin rritur ngarkesat në rrjetin elektrik dhe dëmtonin sistemin e brendshëm elektrik.

Grupi i inspektimit kontrolloi edhe ambientin e kuzhinës, kushtet higjieno- sanitare, si dhe cilësinë e gatimit të ushqimit, brenda normativave dhe menusë javore të miratuar nga drejtuesi i institucionit. Kuzhina e institucionit përbëhej nga ambienti i gatimit dhe ambientet e tjera ndihmëse për vendosjen e pajisjeve frigoriferike dhe magazinave (dhomave) të furnizimit me produkteve ushqimore, të cilat ishin me hapësirë të bollshme. Stafi i kuzhinës përbëhej nga 5 kuzhinerë, prej të cilëve 4 ishin të punësuar sipas organikës, ndërsa 1 ishte në mungesë, si dhe 10 nd/kuzhinerë të punësuar nga institucioni, të gjithë të pajisur me librezë shëndetësore.

Menuja ditore dhe normativat e ushqimit ishin të afishuara në një stendë, ndërsa kampionët e ushqimit ruheshin sipas vakteve ushqimore në kushte frigoriferike. Gatimi i ushqimit kryhej i ndarë më vete për të burgosurit dhe për të sëmurët me diabet. Sistemi i sobave të gatimit dhe ai i aspirimit, ishin funksional. Produktet ushqimore dhe ato të mishit ruheshin në kushte frigoriferike, të ndara në ftohës dhe frigoriferë më vete. Ambienti i kuzhinës në përgjithësi ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjieno-sanitare. Transporti i ushqimit nga kuzhina për në sektorë, kryhej me enë të mëdha në karroca nga shpërndarësit e ushqimit për secilin sektor, kurse brenda godinës, në mungesë të ashensorëve, ushqimi transportohej me krahë nga të punësuarit.

⁷ Në ligjin nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", në nenin 33, pika 3, parashikohet se: "Për çdo të burgosur sigurohet shtrat i veçantë dhe komplet i përshtatshëm fjetjeje". Ndërsa në pikën 4 të nenit thuhet se: "Në vendosjen e të burgosurit mbahen parasysh kushtet e mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar".

Pavarësisht konstatimit tonë dhe rëndësisë që i kushtonte stafi i kuzhinës gatimit të ushqimit, grupi i inspektimit mori ankesa nga të burgosurit edhe për mungesën e larmishmërisë së ushqimit. Kjo problematikë është evidentuar vazhdimisht në rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, por konstatohet se ende nuk ka një përmirësim të larmisë në gatimin e vakteve ushqimore në çdo IEVP, ku sipas të burgosurve gatimi është i njëjtë dhe i pandryshueshëm çdo ditë të javës.

Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të plotësuara sipas rubrikave, të sekretuar dhe të protokolluar.

Masat mbrojtëse

Vëmendje të veçantë, grupi i inspektimit i kushtoi edhe funksionimit të sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve, këqyrjen dhe plotësimin e dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera nga stafi i institucionit, për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Nga verifikimi i disa praktikave, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave të të burgosurve funksiononte sipas procedurave të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*⁸. Kërkesat apo ankesat e të burgosurve pasi regjistrohen në regjistrin përkatës, protokollohen nga sekretaria e institucionit. Regjistri ishte i sekretuar dhe administrohej nga punonjësja e ngarkuar me këtë detyrë.

Të burgosurit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese, ia dorëzonin punonjësit të sektorit të çështjeve shoqërore sipas sektorëve. Punonjësi i këtij sektori brenda ditës i përcillte ato në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe më tej, i kalonin drejtorit të institucionit për adresimin e tyre sipas sektorëve përgjegjës. Kthimi i përgjigjes bëhej me shkrim ose verbalisht në takimet me të burgosurit. Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjes i ankesave dhe kërkesave të të burgosurve, kryhej shpejt dhe jo më vonë se 14 ditë, sipas afatit të përcaktuar në neni 59 të ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*⁹.

Në rastin kur drejtori i institucionit nuk shprehet me vendim për zgjidhjen e kërkesës apo ankesës, të burgosurve, ju lind e drejta të ankohen në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i burgosuri ka të drejtë t’i drejtohet edhe gjykatës kompetente sipas parashikimeve të nenit 80 të këtij ligji¹⁰.

Në ambientet e regjimit të brendshëm, ishin të vendosura kuti postare për depozitimin e ankesë/kërkesave që të burgosurit i drejtojnë Avokatit të Popullit apo institucioneve të tjera shtetërore, jashtë sistemit të burgjeve. Njëkohësisht, ky lloj shërbimi ofrohej edhe nëpërmjet pagesës së zarfit dhe pullës postare nga vetë i burgosuri, ndërsa dërgimi në postë kryhej nga një prej punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore.

⁸ Në nenin 58 thuhet shprehimisht se: *“Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose të ankesave të të burgosurve në formë shkresore dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit, si dhe procedura për kthimin e përgjigjes përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve”*.

⁹ Neni 59/1 i ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* parashikon se: *“Organet kompetente, sipas këtij ligji, shqyrtojnë ankesën dhe kërkesën sa më parë, por jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja, përveç rasteve kur ky ligj parashikon afate të posaçme për shqyrtimin e tyre”*.

¹⁰ Neni 80 i ligjit nr. 81/2020 parashikon: *“Kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale”*.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për periudhën një vjeçare ishin të regjistruara 5865 kërkesë/ankesa, nga të cilat 3435 ishin kërkesa për takime me familjarët dhe skype, 1170 i takonin sektorit juridik për dinamikën e vuajtjes së dënimit, 700 kërkesa për punësim, si dhe për transferime në IEVP të tjera. Pjesa tjetër konsistonin më së shumti në kërkesa për vizitë te mjeku ose për në Spitalin Rajonal të Fierit, kërkesa për takim në dhomën e prindërimit, kërkesa për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer, etj.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët ndodhet në katin e parë të godinës në hyrje të regjimit të brendshëm. Ambienti përbëhet nga 11 poste për takimin e të burgosurve me familjarët, 6 poste ku janë instaluar kompjutera për takime online, 2 dhoma prindërimi për të burgosurit familjarë, 2 dhoma për takime me prokurorë dhe avokatë mbrojtës, 8 dhoma për takime speciale të të dënuarve familjarë, si dhe disa dhoma që shërbenin për takime të drejtorit të IEVP-së me të burgosurit, dhoma për mbledhjet e komisionit të pritjes, etj.

Vendet e takimeve me familjarët, janë të ndara në mes me xham dhe komunikimi i të burgosurve me familjarët bëhet me anë të një prerje rrethore të xhamit në mes. Të burgosurit ngrinin si shqetësim, mungesën e kontakteve fizike me familjarët e tyre, ndaj ata kërkonin të hiqej xhami dhe të kishin mundësi kontakti fizik me familjarët.

Këtë shqetësim e ka konstatuar edhe CPT në vizitën inspektuese të zhvilluar në Shqipëri në datat 4-15 Maj 2023 dhe në raportin drejtuar autoriteteve të Qeverisë Shqiptare, ku ka theksuar se: *“Pavarësisht rekomandimeve specifike të bëra në mënyrë të përsëritur nga Komiteti në të kaluarën, me përjashtim të të burgosurve të dënuar nën regjimin e sigurisë së lartë, vizitat afatshkurtra ende kryhen në kushte të mbyllura, me të burgosurit dhe vizitorët e tyre, të ndarë nga një ndarje xhami ose me shufra metalike”*¹¹. Në këto kushte, CPT ka përsëritur edhe një herë sugjerimin se, për të gjitha kategoritë e të burgosurve, organizimet e vizitave të hapura (për shembull, rreth një tavoline) duhet të jenë rregull, dhe ato të mbyllura përjashtim - bazuar në vendime të drejta dhe të arsyetuara pas vlerësimit individual të rrezikut potencial që paraqet një i burgosur i caktuar.

Në përfundim të analizës të këtij konstatimi CPT i ka rekomanduar autoriteteve shqiptare: ***“Të rishikojnë masat për vizita afatshkurtra në institucionet e vizituara (dhe, sipas rastit, në institucionet e tjera të burgjeve), në mënyrë që të sigurohet që vizita të tilla të kryhen, si rregull, në kushte të hapura”***.

Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua se takimet me familjarët zhvilloheshin 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online (kjo në varësi dhe të kërkesës të të burgosurit). Veç takimeve fizike, të burgosurit familjarë mund të zhvillonin edhe takime në dhomat e prindërimit në distancë, si dhe takimet speciale në ambientet e dedikuara për këtë qëllim.

Komunikimi me telefon i të burgosurve me familjarët zhvillohej 8 herë në muaj, sikurse është e përcaktuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Aparatët telefonik, ishin të instaluar në korridoret e secilit sektor në regjimin e brendshëm dhe në ambientin e ajrimit. Aparatët ishin në gjendje pune dhe nga intervistat të burgosurit deklarorin se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë.

Nga intervistat me të burgosurit, nuk pati ankesa për mosrespektimin e numrit të takimeve me familjarët, apo zëvendësimin e takimeve fizike me takime online me familjarët.

¹¹ Janë bërë përjashtime për familjet me fëmijë të vegjël, rast në të cilin rast lejohen vizitat e hapura.

Grupi i inspektimit, verifikoi komunikimin me telefon me Institucionin e Avokatit të Popullit, në numrat e kontaktit që ishin të afishuar në hollin e secilit sektor. Nga verifikimi rezultoi se, të burgosurit mund të komunikojnë në çdo kohë dhe pa pagesë, sikurse parashikohet në ligjin nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Dhomat e prindërimit në distancë ishin të pajisura me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige, nga ku të burgosurit mund të takonin fizikisht fëmijët e tyre. Gjatë takimeve të të burgosurit me fëmijët dhe familjarët e tyre, në këto ambiente respektoheshin masat e sigurisë, si dhe privatësia e takimit.

Dhoma e cila shërbente për takimet e të burgosurit me avokatët mbrojtës, ishte e pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, për qëndrimin ulur dhe zhvillimin e seancave të marrjes në pyetje të të dënuarve, sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Veç ambienteve në godinën ku ndodhen postet e takimeve, në një nga hapësirat midis godinave të banimit, është krijuar me ndihmën e financimit të një donatori (Banka RFZB, dega Fier), një mjedis i veçantë për takimin e të burgosurve me familjarët dhe fëmijët e tyre. Ky mjedis është i hapur rrethuar nga një lulishte, ku janë vendosur tavolina, karrige dhe lodra për fëmijët, të mbuluara me çadra për tu mbrojtur nga dielli apo dhe shiu.

Grupi i inspektimit, i kushtoi rëndësi të veçantë trajtimit të të burgosurve 18-21 vjeç. Këta të burgosur nuk ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Në momentin e inspektimit, ndodheshin 9 të burgosur të kësaj grupmoshe, nga të cilët 8 persona me status të paraburgosur dhe 1 të dënuar. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Nga intervistat e zhvilluara, u evidentua se punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore zhvillonin programe sipas planit individual të trajtimit, ku përfshihet trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i të burgosurve.

Avokati i Popullit vlerëson se për këta të burgosur duhet të ketë një procedurë të veçantë dhe më konkretisht, duhet të merret mendimi i të burgosurve të grupmoshës 18-21 vjeç për qëndrimin pranë vendbanimit dhe atij të të qenit me bashkëmoshatarët.

Në IEVP Fier, organika e të burgosurve të punësuar kishte të miratuar 52 persona dhe në listëpagesën e muajit të fundit rezultonin të punësuar 51 të burgosur në pozicionet e punës, si sanitar, punë në lavanderi, nd/kuzhiner, mirëmbajtës, berber, etj. Institucioni kishte lidhur kontratë pune me të burgosurit e punësuar dhe pagesat kryheshin çdo muaj, duke i derdhur në numrin e llogarisë të të punësuarit në bankat e nivelit të dytë. Krahas masave të ndërmarra nga institucioni, grupit të inspektimit ju paraqitën ankesa nga 3 të burgosur, të cilët nuk kishin marrë pagesat mujore për punën e kryer. Nga interesimi pranë drejtuesve të institucionit rezultoi se, fondi për të punësuarit ishte në buxhetin e institucionit, por kjo situatë ishte krijuar për shkak të mungesës së kartave ID të të punësuarve, e cila do t'u jepte mundësi atyre për hapjen e numrave të llogarisë në një nga bankat e nivelit të dytë. Për këtë situatë drejtuesit e institucionit ishin të angazhuar për t'i dhënë një zgjidhje sa më të shpejtë, duke i pajisur ata me kartat e identitetit.

Ndërkohë, kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i

inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e MKPT-së, ato do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse nëpërmjet Seksionit të Veçantë.

Grupi i inspektimit konstatoi se në korridoret e I EVP Fier ishin afishuar posterat me të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve për t'u njohur sa më mirë me të drejtat e tyre.

Sistemi i kamerave ishte funksional. Ato mbajnë në vëzhgim ambientet në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm gjatë 24 orëve, pamjet e të cilave monitorohen nga salla operative e I EVP-së. Pamjet filmike ruhen në server për një afat 30 ditor dhe administrohen nga specialisti i IT.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij kishte edhe monitorimin e kushteve materiale në institucion, si kusht i rëndësishëm për respektimin e standardeve të jetesës të të dënuarve/ paraburgosurve. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier kishte një infrastrukturë funksionale me ndarje të rregullta të godinave dhe tërësia e masave të marra garantonin përgjithësisht elementët e sigurisë.

Ndërtimi i I EVP Fier është realizuar në kuadër të programit IPA 2007-2010 dhe është vënë në shfrytëzim nga muaji shkurt i vitit 2015. Infrastruktura në regjimin e brendshëm afon kushte të përshtatshme për akomodimin e të burgosurve, zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe edukuese, shërbim shëndetësor dhe stomatologjik, asistencë juridike, asistencë psikologjike dhe sociale, kurse të formimit profesional, etj.

Sikurse përmendëm edhe më lart, në regjimin e brendshëm ndodhen 5 godina me tre kate, 1 (një) godinë për të paraburgosurit, 3 (tre) godina për të dënuarit dhe 1 (një) godinë për shërbimet ndihmëse. Çdo godinë banimi ka më vete ambiente të përbashkëta për aktivitete, mjedise ajrimi dhe fushë sporti (kalçeto) për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Çdo sektor i godinave të regjimit të brendshëm, ka dhoma banimi, klasë edukimi dhe dhomë për këshillime individuale, dushe dhe dhomë për lavanderinë. Ndërsa klasat ku zhvillohej mësimi 9-vjeçar, kurset profesionale, biblioteka dhe ambientet e kultit, janë të përbashkëta të ndara më vete sipas interesave dhe besimeve fetare të të burgosurve. Po ashtu, në godina ka shumë ambiente (dhoma) që janë të boshatisura dhe pa funksione. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ato ambiente janë të ndërtuara që në zbatimin e projektit, por nuk përdoren, pasi për ti vënë në funksion, kërkohen stafe mbështetëse dhe staf sigurie sipas strukturës organike të miratuar.

Godinat e banimit për të dënuarit (A, B dhe C) në përgjithësi, plotësojnë nevojat e të dënuarve për jetesë normale dhe garantojnë elementët e sigurisë. Të dënuarit ishin akomoduar në dhoma me kapacitet nga 1 deri në 3 persona. Dhomat ishin të mëdha me hapësirën dhe sipërfaqen e lejueshme për banim. Gjatë inspektimit u konstatua se, dhomat e banimit ishin të kompletuara me krevate për fjetje, tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur dhe me tualete brenda tyre. Të dënuarit ishin të furnizuar me materiale për fjetje si dyshekë, jastëk, çarçafë dhe batanije.

Ndërsa, në godinën e banimit për të paraburgosurit (D) është me 3 kate, me 2 sektorë banimi në secilin kat. Godina ka 108 dhoma banimi, të cilat kanë sipërfaqe dhe kubaturë të mjaftueshme për akomodimin deri dy persona në dhomë.

Nga inspektimi, u konstatua se në disa dhoma banimi, ishin të akomoduar 3 persona, duke mos u respektuar standardi i kubaturës dhe sipërfaqes jetike për person të përcaktuar në aktet normative. Si rrjedhojë e mbipopullimit në këto dhoma kishte të paraburgosur që flinin me dyshek në dysHEME. Kjo gjendje përbën trajtim degradues të të paraburgosurve që qëndronin në këto ambiente.

Ndërkohë, në sektorët 1 të godinës së paraburgimit ishin akomoduar ish-zyrtarë të lartë dhe sektorin 5, ishin akomoduar persona me statusin e të paraburgosurit që gëzonin kushte të mira jetese. Në këto sektorë vërehej një përmirësim i dukshëm i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve. Ambientet e dhomave paraqiteshin me kushte të mira ndryshe nga gjithë sektorët e tjerë. Dhomat në këto sektor ishin të lyera, të pajisura me krevate të rinj dhe gjithashtu orendi si dollapë, tavolina, kondicioner toke etj. Këto sektorë ishin pajisur me një palestër për zhvillimin e aktivitetit sportiv. Tualetet ndodheshin brenda dhomave dhe ishin të pajisura me nga një post dushi. Gjithashtu, në hollin e sektorit 5 ishte përshtatur një ambient gatimi i cili ishte pajisur me sobë, raft për mbajtjen e ushqimeve, enë guzhine etj.

Ndërsa në sektorët e tjerë të kësaj godine, ambienti i dushit për larjen e trupit, ishte i përbashkët për të paraburgosurit në bazë sektori. Çdo mjedis dushi kishte 4-6 poste për larjen e trupit, ku në disa prej tyre u konstatua mungesa e kokave të dusheve ose koka dushi të dëmtuara. Për këtë arsye, disa poste dushi, ishin jo funksionale dhe të paraburgosurit ishin detyruar që të ngrohnin ujin me rezistenca elektrike në dhomat e banimit, duke përbërë rrezik për jetën dhe njëkohësisht mbingarkojnë rrjetin e brendshëm të furnizimit me energji elektrike.

Lidhur me këtë situatë, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se mosfunksionimi i dusheve të përbashkëta me kapacitet të plotë për larjen e trupit të të burgosurve dhe mos garantimi i kushteve higjieno-sanitare nga ana e IEVP-së përbën trajtim jo dinjitoz të tyre në shkelje të nenit 32, pika 4 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të Burgjeve të miratuar me vendim nr. 209, datë 6.4.2022, ku thuhet se: *“Të burgosurit i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën, kur është e mundur, dushi mund të bëhet çdo ditë ose të paktën 3 (tre) herë në javë gjatë stinës së verës dhe 2 (dy) herë në javë gjatë stinës së dimrit ose më shpesh nëse është e nevojshme, në interes të higjienës së përgjithshme”*.

Dritaret e dhomave kanë përmasa të tilla që lejojnë depërtimin e ajrit dhe dritës natyrale. Ambientet e banimit, ambientet ndihmëse dhe ambientet e përbashkëta kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Në rast ndërprerje të energjisë elektrike apo të defekteve në rrjetin elektrik, institucioni kishte gjenerator për secilën godinë, që shërben si burim rezervë për furnizimin me energji elektrike.

Ambienti i dhomave të banimit, korridoret e përbashkëta, dushet dhe klasat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Përgjithësisht nën ambientet e katit të parë në godinën e të paraburgosurve ku u evidentua se, në këto ambiente kishte lagështirë dhe nuk ishin të mirëmbajtura.

Në çdo sektor ishin krijuar dhoma që shërbenin si palestër, të cilat përgjithësisht ishin të kompletuara me pajisje dhe vegla force. Ambiente që shërbenin për palestër kishte edhe në godinën e të paraburgosurve, por ato nuk ishin të kompletuara me vegla force dhe të paraburgosurit kishin përshtatur disa pajisje force me mjete rrethore.

Qëndrimi në palestër kryhej sipas orarit të veprimeve të miratuara nga drejtori dhe shefi i policisë në këtë institucion. Të gjithë të burgosurit e pyetur nga ana e grupit të inspektimit,

pohuan se për të frekuentuar palestrën bënin kërkesë pranë sektorit social në institucion dhe sipas listës mujore zhvillonin aktivitetin fizik.

Klasat e edukimit në çdo sektor u shërbejnë punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore për takime me të dënuarit dhe të paraburgosurit në rastin e marrjes së kërkesë/ankesave, për trajtime individuale psiko-sociale sipas programeve të miratuara, si dhe takime me grupe të vogla të burgosurish. Në këto ambiente, sipas orarit të veprimeve, zhvillohen gjithashtu dhe lojëra tavoline nga të burgosurit në bazë sektori.

Çdo sektor ka holl në korridorin e përbashkët, të pajisur me tavolina dhe stola të gjatë për qëndrimin ulur (me këmbë të fiksuara në dysHEME), ku të burgosurit sipas grafikut të miratuar nga sektori i policisë, mund të qëndrojnë pas orarit të ajrimit, me grupe të vogla për kalimin e kohës së lirë.

Lavanderia e institucionit ishte në gjendje funksionale, e pajisur me lavatriçe për larje dhe tharje të materialeve të fjetjes si batanije dhe çarçafë. Ndërsa rrobat personale, vazhdonin të laheshin nga familjarët ose nga vetë të burgosurit brenda ambientit të dhomave. Në këtë kuadër ata kërkonin shtimin me një lavatriçe tjetër për ofrimin sa më parë të këtij shërbimi.

Furnizimi me ujë i ambienteve të institucionit kryhej me orar sipas grafikut, tre herë në ditë me nga 3 orë. Sipas të burgosurve, koha e furnizimit me ujë është e pamjaftueshme dhe nuk përballon njëkohësisht mbajtjen e higjienës personale dhe pastërtinë e ambienteve të banimit. Të burgosurit kërkojnë të ketë furnizim pandërprerje me ujë gjatë ditës ose minimalisht të zgjatet orari i furnizimit me ujë.

Një nga shqetësimet e ngritura në intervistat me të burgosurit në disa sektorë ishte mungesa e një ambienti më vete për tharjen e rrobave, pasi në mungesë të një ambienti më vete, tharja e rrobave kryhej brenda dhomave të banimit, duke përdorur mjete të tilla si **kordona apo litarë** për varjen dhe tharjen e tyre. Mbajtja e kordonëve apo litarëve në dhomat e banimit përbën rrezik për jetën, kryesisht të atyre personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, por dhe për sigurinë e të burgosurve të tjerë.

Në godinat e IEVP Fier kishte ashensorë, por ata ishin jashtë funksionit për shkak të mos mirëmbajtjes së tyre dhe në këtë mënyrë vështirësohej puna për të burgosurit e punësuar në kuzhinë për shpërndarjen e ushqimit sipas sektorëve në IEVP Fier.

Në IEVP Fier funksiononte rregullisht njësia tregtare online, për blerjen e produkteve të nevojshme për të burgosurit. Nga ana e subjektit privat që ofron këtë shërbim, ishte krijuar mundësia që të burgosurit të kryenin porositë nëpërmjet pajisjes “iPaid” në dispozicion të tyre. Brenda 2-3 ditëve, porositë dërgohen nga subjekti privat nominalisht sipas kërkesave të të burgosurve. Në intervistat me të burgosurit, ata nuk ngritën ndonjë shqetësim në këtë drejtim.

Regjimi dhe aktivitetet

Aktiviteti dhe veprimtaritë ditore me të burgosurit në IEVP Fier, ishin të organizuar sipas orarit ditor të miratuar nga drejtori i institucionit. Aktiviteti kryesor që zhvillohej me të burgosurit jashtë ambientit të qelive, ishte ajrimi i cili kryhej rregullisht çdo ditë sipas orareve të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve dhe i ndarë sipas stinëve¹².

¹² Neni 37 i ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

Ambientet e ajrimit dhe fushat kalçeto janë të ndara më vete për secilën godinë banimi. Nga pikëpamja e ndërtimit, e hapësirës dhe gjatësisë që kanë, vendet e ajrimit plotësojnë kushtet për ajrim dhe të sigurisë për të burgosurit.

Aktivitetet me karakter kulturor dhe sportiv, me pjesëmarrjen e gjerë të të burgosurve sipas sektorëve, zhvilloheshin në bazë të programit të miratuar nga drejtori i institucionit dhe shefi i policisë, nën mbikëqyrjen e punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore dhe punonjësve të sigurisë në regjimin e brendshëm.

Pavarësisht programeve, të burgosurit ngrinin shqetësimin se duhen të organizohen aktivitete të larmishme me karakter edukativ, kulturor dhe sportiv dhe me pjesëmarrjen e të burgosurve sipas godinave. Aktivitetet e vetme që zhvilloheshin në ajrim ishin aktivitete në rastin e festave kombëtare apo festave fetare, si dhe lojërat e tavolinës dhe ndeshjet e futbollit në kalçeto. Në klasat e edukimit zhvillohen programet individuale të këshillimeve dhe në grupe të vogla me të burgosurit.

Larmia e aktiviteteve dhe pjesëmarrja e gjerë e të burgosurve, ndikojnë jo vetëm në marrëdhëniet midis të burgosurve dhe socializimin e tyre, por është dhe një nga detyrimet e institucioneve penitenciare, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve, në momentin kur ata përfundojnë kohën e vuajtjes së dënimit. Për këtë qëllim, edhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon qartazi se: *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹³.

Edhe KPT në vizitën e fundit të zhvilluar Shqipëri (4-15 maj 2023), ka konstatuar mungesën e aktiviteteve të larmishme në IEVP Fier, ku *“mjeti kryesor i shpërqendrimit të të paraburgosurve ishte duke luajtur lojëra në tavolinë, duke lexuar dhe shikuar televizor (nëse kishte një të tillë në qeli). Kjo plogështi ndërpritej herë pas here nga vetëm vizitat e avokatëve, seancat gjyqësore apo vizitat familjare”*.

Për sa më sipër, KPT: *“U bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e nevojshme në Burgjet e Fierit, Peqinit dhe Tepelenës dhe në Burgun nr. 313 (dhe në burgjet e tjera në Shqipëri ku mbizotëron një situatë e ngjashme) për të përmirësuar ndjeshëm regjimin e veprimtarive për të gjithë të burgosurit, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Qëllimi duhet të jetë të sigurohet që të burgosurit të jenë në gjendje të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (d.m.th., tetë orë ose më shumë) jashtë qelisë së tyre, të përfshirë në aktivitete të qëllimshme të natyrave të ndryshme (si punë, arsim, trajnim profesional, sport, dhe aktivitete rekreative/ shoqërimi)”*.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit vlerëson masat e marra nga sektorët e çështjeve shoqërore në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve që ndikojnë në qëndrueshmërinë psiko-sociale të të burgosurve, por sugjeron trajnimin e vazhdueshëm të këtyre punonjësve, me qëllim ngritjen profesionale të tyre dhe përdorimin e teknikave të reja në këshillimet individuale dhe në grup me të burgosurit, kryesisht atyre që kanë probleme të shëndetit mendor.

IEVP Fier ka një bashkëpunim të mirë me Qendrën e Formimit Profesional (QFP) në Fier, në organizimin e kurseve profesionale 3-mujore. Nga informacioni, në këtë institucion

¹³ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2;
<http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

ishte efektiv kursi për “kuzhinë” me pjesëmarrjen e 12 të burgosurve, si dhe kurs për 9 të burgosur për mësimin e gjuhës së huaj anglisht.

Gjithashtu na u bë me dije nga stafi social se ishin në projekt për hapjen edhe të kurseve të tjera profesionale. Kërkesat për zhvillimin e kurseve profesionale nga të burgosurit janë të shumta, por QFP Fier nuk ka kapacitetet e nevojshme për sigurimin e instruktorëve sipas kërkesave të këtij institucioni.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Fier, në këtë institucion zhvillohej një klasë mësimi e nivelit 9-vjeçar me 10 të burgosur. Ky program bashkëpunimi, ka filluar të zbatohet në bazë të një marrëveshje që ky institucion ka me ZVA Fier që nga viti 2018. Avokati i Popullit vlerëson përmirësimin e lehtë të situatës së aktiviteteve në këtë IEVP dhe shpreh bindjen se një gjë e tillë ndikon thelbësisht në realizimin e funksionit integruar të sistemit penitenciar në Shqipëri.

E drejta e besimit dhe ushtrimit të rriteve fetare nga të burgosurit, respektohej në këtë institucion. Aktivitetet fetare zhvilloheshin me pjesëmarrjen e të burgosurve sipas besimeve fetare dhe përfaqësuesit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Fier dhe atyre nga Shoqata Kristiane e të burgosurve shqiptar. Ato zhvilloheshin në mjedise të veçanta që ndodhen në regjimin e brendshëm, çdo javë sipas programit të miratuar nga drejtori i institucionit.

Plani individual i trajtimit ishte i hartuar nga sektori i çështjeve shoqërore të institucionit dhe ofrohej prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Për të burgosurit e rinj të moshës 18 deri 21 vjeç, institucioni kishte përgatitur një plan individual trajtimi, ku përfshihet trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i tyre. Vlerësimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhej nga personeli i sektorit të edukimit në bashkëpunim dhe me sektorët përkatës të institucionit.

Biblioteka dhe klasat e edukimit të institucionit, ishin të kompletuara me libra nga DPB-ja, por dhe nga sponsorizime të donatorëve nga qyteti i Fierit, duke i përmbushur kërkesat për lexim të të burgosurve. Të burgosurit pasi regjistroheshin në një regjistër nga punonjësi i bibliotekës, u hapej kartela personale dhe më pas mund të tërhiqnin e dorëzonin librat sipas kërkesave të tyre.

Avokati i Popullit vlerëson se DPB duhet të gjejë forcat dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme për të shtuar numrin e kurseve profesionale në mënyrë që të përgatiten të burgosurit për të dalë më pas në jetë e për tu larguar nga veprimtari të paligjshme përsa është e mundur.

Nga verifikimi i dosjeve psiko-sociale për çdo të dënuar dhe të paraburgosur, u evidentua se ato ishin të plotësuara në rregull, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarin apo të paraburgosurin, vlerësimet e kryera nga punonjësi i edukimit sipas 3 mujorëve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Shërbimi Shëndetësor

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në IEVP Fier i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të burgosurve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe i krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Sektori shëndetësor, kishte në organikë 16 punonjës, nga të cilët 3 mjekë (2 mjek të përgjithshëm dhe 1 mjek psikiatër), 1 mjek stomatolog, 1 farmacist, 1 kryeinfermier dhe 10 (dhjetë) infermierë. Aktualisht institucioni ka të punësuar 2 mjekë të përgjithshëm me kohë të pjesshme, ndërkohë që mungon një mjek me specialitet psikiatër. Bazuar në kushtet e kontratës së punës, mjekët kryenin vizita mjekësore sipas orareve, 4 (katër) orë çdo ditë, duke i alternuar oraret me qëllim që njëri prej tyre të ishte prezent në institucion, ndërsa për rastet urgjente mjekët paraqiten menjëherë në institucion. Pjesa tjetër e stafit shëndetësor, ishte e plotësuar me mjek dhe infermier sipas organikës dhe ishin të punësuar me kohë të plotë.

Lista e të sëmurëve përbëhej nga 195 të sëmurë kronikë, 70 të sëmurë me diabet, 19 persona ish-përdorues të substancave narkotike që trajtohen me “metadon”, ndërsa persona të sëmurë të shëndetit mendor ishin 66 të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë. Këta persona trajtohen çdo ditë me medikamente, por ishin në kontroll të përditshëm nga mjeku i institucionit dhe stafit të infermierëve që kryenin shërbim 24 orësh. Personeli i infermierëve të institucionit, u jepte terapinë këtyre shtetasve sipas rekomandimeve të lëna nga mjekët psikiatër, duke qenë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mbikëqyrnin me rigorozytet administrimin e tyre.

U evidentua se, të burgosurit me probleme shëndetësore i drejtonin kërkesë drejtorit të institucionit dhe pas miratimit të kërkesës, ata kryenin vizita mjekësore në ambientet e spitalit të institucionit nga stafi i mjekëve. Krahas vizitave mjekësore nga mjekët e institucionit, trajtimi i të sëmurëve kronikë dhe i rasteve urgjente, me rekomandim të mjekut, të burgosurit shoqëroheshin për vizita mjekësore pranë mjekëve specialistë të Spitalit Rajonal Fier dhe në IVSHB (Spitalin e Burgjeve) në Tiranë. Institucioni ka në dispozicion edhe një mjet ambulancë, e cila është e re dhe në gjendje pune.

Sikurse përmendëm më lart, IEVP Fier ka një ambient më vete që shërben si spital, i pajisur me dhoma për personelin shëndetësor dhe dhoma për shtrimin e sëmurëve, sipas rekomandimit të mjekëve të institucionit. Shërbimi shëndetësor ishte funksional dhe i organizuar përgjatë 24 orëve. Në këtë mjedis ndodhen 11 dhoma shtrimi, dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, ambienti i farmacisë të institucionit, si dhe disa dhoma të tjera që shërbenin si ambiente ndihmëse për personelin shëndetësor. Në kohën e inspektimit ndodheshin të shtruar 4 (katër) pacientë të sëmurë kronikë, me rekomandim të mjekut të institucionit.

Në regjimin e brendshëm ndodhet edhe Sektori i Kujdesit të Veçantë (SKV) me 18 dhoma dhe në momentin e inspektimit kishte 13 pacientë të shtruar me probleme të shëndetit mendor.

Dhomat e shtrimit në spital dhe në SKV janë të kompletuara me materialet e fjetjes, tualete brenda në çdo dhomë, si dhe ambient dushi më vete. Dhoma e mjekut, farmacistit dhe dhoma e urgjencave ishin të kompletuara me të gjitha orëditë dhe pajisjet e nevojshme (rafte, tavolina pune, karrige, si dhe shtrat për kryerjen e vizitave mjekësore), që nevojiten për ndjekjen e protokollit shëndetësor për të sëmurët kronikë ashtu edhe për rastet e urgjencave. Gjithashtu edhe dhoma e stomatologut ishte e kompletuar me sterilizues, karrige dhe unit (poltron) funksional.

Në katin e parë të secilës godinë banimi ka nga një dhomë për infermierët e turnit, të cilat kanë hapësirë e sipërfaqe të vogël, por me kushte të mira higjieno-sanitare. Në këtë ambient, infermierët mbanin një sasi të vogël të ilaçeve për rastet e urgjencave. Për

shoqërimin e të sëmurëve në rastin e vizitave mjekësore apo të urgjencave për në spitalin e Fierit, IEVP Fier ka në dispozicion një automjet ambulancë të re.

Furnizimi me ilaçe i institucionit për të sëmurët kronikë, funksiononte rregullisht sipas skemës së rimbursimit mes FDSKSH-IEVP-Depo Farmaceutike. Nga intervistat e pacientëve me sëmundje kronike, u ngrit si shqetësim mungesa në listën e rimbursimeve e disa medikamenteve që përdoren nga ana e tyre (sipas emërtimeve), ndaj në këto kushte ata vijonin të merrnin ilaçet nga familjarët e tyre.

Në rastet e pacientëve me sëmundje patologjike dhe të urgjencave, furnizimi me medikamente kryhej normalisht nga farmacisti i institucionit. Farmacia e institucionit, furnizohej me medikamente rregullisht 2 herë në vit nga DPB-ja, ndërsa për nevoja urgjente, institucioni ka në dispozicion një fond të veçantë në buxhet për blerjen e medikamenteve. Shpërndarja e ilaçeve për të sëmurët sipas kategorive, kryhej nga personeli i infermierëve sipas turneve të shërbimit 24 orë, na bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit.

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të medikamenteve, që kanë kaluar afatin e skadencës, drejtori i institucionit në bashkëpunim me sektorin e shëndetësisë, kishin ngritur një grup pune për kontrollin e skadencave të medikamenteve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, sipas procedurave ligjore për shkatërrimin e tyre.

Protokollet shëndetësore dhe regjistrat e shërbimit 24 orë të infermierëve, ishin të protokolluara në sekretari, të plotësuar sipas rubrikave dhe ishin mbajtur në rregull.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa, për zgjidhjen e situatës së mbipopullimit në sektorin e paraburgimit, në zbatim të nenit 33, pika 3 të ligjit nr. 81 /2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet se çdo të burgosuri sigurohet shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
2. Marrjen e masave, për garantimin e akomodimit të të dënuarëve dhe të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² dhe 4m² për person.

3. Marrjen e masave të menjëhershme, për rishpërndarjen e të burgosurve në mënyrë proporcionale duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorin e paraburgimit. Të shmanget diferencimet në trajtimin e të dënuarëve dhe paraburgosurve që kanë të bëjnë me ambientet e banimit.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit për të burgosurit në të gjithë sektorët e burgut në mënyrë që të shmanget diskriminimi dhe të kemi një trajtim të barabartë për ta.
5. Marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarëve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.
6. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit, kryesisht në stafin e policisë (31 vende vakante), për të garantuar sigurinë ndaj të burgosurve që vuajnë dënimin në këtë institucion.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e pozicionit të mjekut psikiatër dhe shtimin e numrit të infermierëve në institucion, kjo nisur nga numri i lartë i të burgosurve që ndodhen në institucion si dhe duke u bazuar dhe në rekomandimet e CPT përgjatë vizitës së zhvilluar në IEVP Fier në maj 2023, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor për të burgosurit, mbi bazën e standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe protokolleve shëndetësore, sipas kategorive të të sëmurëve.
8. Të merren masat e menjëhershme, për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit, me 1 kuzhiner, 1 specialist për ushqimin dhe 2 punonjës social sipas organikës së miratuar.
9. Të merren masat e nevojshme, për eliminimin e lagështirës në godinën e të paraburgosurve dhe për vënien në funksion të të gjitha dusheve, për të mundësuar larjen e trupit në dushe me ujë të ngrohtë, sipas rregullores, por edhe sipas nevojave të tyre në çdo kohë, si dhe lyerjen e ambienteve për të qenë sa më të pastra nga ana higjieno-sanitare.
10. Të merren masat e nevojshme nga drejtoria e IEVP-së Fier në bashkëpunim me ndërmarrjen e UK në Fier, për rishikimin e orarit dhe furnizimin pa ndërprerje me ujë të ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit.
11. Të merren masa të menjëhershme, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori ose të udhëzohet marrja e një miratimi/mendimi me shkrim prej të burgosurve nën 21 vjeç.

12. Marrjen e masave, për pajisjen e lavanderisë me lavatriçe shtesë, për ofrimin sa më parë të këtij shërbimi, në mënyrë që të jetë në proporcion me numrin e personave të akomoduar.
13. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndryshimin e menusë së ushqimit për ta bërë atë sa më të larmishme dhe përshtatjen e vakteve ushqimore, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, gjendjes shëndetësore, kushteve klimaterike, besimit fetar dhe nevojave të veçanta të tyre.
14. Marrjen e masave të menjëhershme nga sektori i sigurisë së institucionit, për heqjen e litarëve në dhomat e banimit që përdoren nga të paraburgosurit për tharjen e rrobave, si element që cënon sigurinë, por edhe si mjet që mund të përdoret për dëmtimin e jetës, kryesisht nga persona që kanë probleme me shëndetin mendor.
15. Marrjen e masave të nevojshme, për vënien në funksion të ambienteve të pashfrytëzuara, të cilat qëndrojnë të mbyllura në institucion.
16. Marrjen e masave për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve me orëndi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.
17. Marrjen e masave për heqjen e xhamit ndarës në postet e takimeve fizike të të burgosurve me familjarët e tyre, duke mundësuar takime në kushte të hapura sipas rekomandimeve të CPT-së për Shqipërinë.
18. Marrjen e masave për rivënien në punë të ashensorëve në të 4 godinat e IEVP Fier
19. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për identifikimin e personave përgjegjës për moszbatimin e rekomandimeve pa implikime buxhetore të Avokatit të Popullit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

dv

